

## Njoftim

Sot, më datë **18.04.2023, ora 15:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Alma Kolgjoka (Relatore);**
- 2. Edlira Petri (Anëtare);**
- 3. Emona Muçi (Anëtare);**
- 4. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 5. Marsela Dervishi (Anëtare).**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Tiranë, salla 2, pasi shqyrtoi çështjen Nr.10 Regj.Themeltar, Datë 11.04.2023 Regjistrimi, me:

**Paditës:** Eduart Muhamet Nallbani.

**I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**Objekti:**

1. Rrëzimin e Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 220, datë 30.03.2023.
2. Rrëzimin e Vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve nr. *(nuk është publikuar ende)*, datë 04.04.2023.
3. Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendim për regjistrim të z. Eduart Muhamet Nallbani, si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**Baza ligjore:** Neni 45 i Kushtetutës së R.SH.; Neni 70, 145 e vijues të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

me Vendimin Nr.10, datë 18.04.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

### VENDOSI:

1. Rrëzimin e padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
4. U shpall në Tiranë më datë 18.04.2023.

**Tiranë, më 18.04.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit**